REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA E AUTORIZIMIT TË PAGESAVE

Nr._____prot. Tiranë, më__.___.2026

Njoftim për afatin e dorëzimit të kërkesave për pagesë për kontratat e investimit të Skemës Kombëtare 2025

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) njofton përfituesit e Skemës Kombëtare 2025, të cilët, sipas kontratave të investimit, kanë afat për dorëzimin e kërkesave për pagesë deri më 30 nëntor 2026, se **dita e fundit për dorëzimin e kërkesave për pagesë është dita e Mërkurë, 2 Dhjetor 2026**.

Në vitin 2026, festat zyrtare të 28 Nëntorit "Dita e Flamurit dhe e Pavarësisë" dhe të 29 Nëntorit "Dita e Çlirimit", bien përkatësisht të shtunën dhe të dielën. Për këtë arsye, dita e hënë 30 Nëntor 2026 dhe dita e martë, 1 Dhjetor 2026, janë ditë pushimi.

Sipas nenit 56, pika 4, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi zyrtar, afati përfundon në ditën e parë pasuese të punës. Të njëjtin rregull për llogaritjen e afateve procedurale parashikon edhe neni 148 i Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, kërkesat për pagesë mund të dorëzohen **deri më 2 Dhjetor 2026, përfshirë këtë datë**.